



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i kuvendit-**

KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK

SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT

**BULETINI
PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
01.01.2011- 31.12.2011**

Kaçanik, 2012

H Y R J E

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në periudhën kohore, 01.01.2011- 31.12.2011.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të kuvendit të komunës për gjatë kësaj periudhës njëvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për vërejtjet dhe sugjerimet që do të jepen në të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhshme të jetë sa më i suksesshëm dhe cilësor.

PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë në zgjedhjet e datës 15.11.2009, numëron gjithsej 27 anëtarë, dhe atë

1.	Xhelal Gashi	PDK
2.	Ilaz Ceka	PDK
3.	Tefik Vishi	PDK
4.	Ramadush Osmani	PDK
5.	Afrim Bunjaku	PDK
6.	Kemajl Murseli	PDK
7.	Driton Thaqi	PDK
8.	Krenare Luzha	PDK
9.	Zekirja Loku	PDK
10.	Habib Guri	PDK
11.	Floriqe Dalloshi	PDK
12.	Arbnora Sallahu	PDK
13.	Diana Bajrami	PDK
14.	Shiqeri Luzha	AAK
15.	Shukri Luta	AAK
16.	Hajdar Loku	AAK
17.	Rami Çaka	AAK
18.	Sevdije Frangu	AAK
19.	Nerimane Lika	AAK
20.	Afërdita Deda	AAK
21.	Daut Rudi	LDK
22.	Ibrahim Hoxha	LDK
23.	Nazife Krasniqi	LDK
24.	Florijeta Gashi	LDK
25.	Ali Krasniqi	AKR
26.	Sherife Troni	AKR
27.	Elife Murseli	LDD.

Më këtë përbërje kuvend i komunës Kaçanik, e ka vazhduar aktivitetin edhe në vitin 2011, pa pasur asnjë ndryshim në spektrin politik.

Ekzekutivi i komunës, në vitin 2011, është në përbërje;

- | | |
|-------------------|---------------------|
| 1. Xhabir Zharku, | kryetar komune, |
| 2. Heset Loku, | nënkryetar komune |
| 3. Jeton Topalli, | drejtor i DAP, |
| 4. Misim Sopa, | drejtor i DSHMS, |
| 5. Fikri Verbani, | drejtor i DEFZH, |
| 6. Azem Guri, | drejtor i DAK, |
| 7. Bekim Troni, | drejtor i DUKMM, |
| 8. Rushan Ceka, | drejtor i DSHPE dhe |
| 9. Nuhi Provoliu, | drejtor i DBPZHR. |

AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Viti 2011

Mbledhja e I- r (Parë)

Me 28.01.2011, është mbajtur mbledhja e I-r e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Planit të mbledhjeve të kuvendit, për vitin 2011,
2. Vendimi për aprovimin e Raportit të punës së Komitetit për politikë dhe financa, për vitin 2010 dhe
3. Vendimi për hartimin e Planit rregullues urban, për Zonën e I-r urbanistike të qytetit të Kaçanikut.

Mbledhja e II-të (Dytë)

Me 28.02.2011, është mbajtur mbledhja e II-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
2. Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2009 dhe 2010, në vitin vijues buxhetor 2011,
3. Vendimi për ndalimin e organizimit të disa lojërave të fatit në territorin e komunës së Kaçanikut.

Mbledhja e III-të (Tretë)

Me 30.03.2011, është mbajtur mbledhja e III-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Raportit të ekzekutivit për periudhën: janar-dhjetor, 2010,
2. Debat i Raportit të Punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2011,
3. Vendimi për formimin e komisionit për grumbullimin e materialit dhe ngritjen e padisë kundër Republikës së Serbisë.

Mbledhja e IV-të (Katërt)

Me 28.04.2011, është mbajtur mbledhja e IV-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për trajtimin e Zonës së I-r Urbanistike dhe Zonës përkufizuese që ka ndikimin në Zonën e I-r,
2. Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, në përbërje:
 1. Rushan Ceka, drejtor i DSHPE,
 2. Fatos Koxha, zyrtar në DUKMM,
 3. Ejup Runjeva, përfaqësues i shoqërisë civile(SHVL),
 4. Ramadush Osmani, anëtar i kuvendit nga subjekti i PDK-së,
 5. Sevdije Frangu “ “ “ “ AAK-së,
 6. Ibrahim Hoxha, “ “ “ “ LDK-së, dhe
 7. Sherife Troni, “ “ “ “ AKR-së.

Mbledhja e V-të (Pestë)

Me 27.05.2011, është mbajtur mbledhja e V-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Raportit Financiar i komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2011,
2. Vendimi për aprovimin e Planit të veprimit rinor lokal për vitet: 2011-2013.

Mbledhja e VI-të (Gjashtë)

Me 05.07.2011, është mbajtur mbledhja e VI-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për transferin e shumave të ndara buxhetore për vitin 2011,
2. Vendimi për Arovimin e Kornizës afatmesme e shpenzimeve të komunës së Kaçanikut për vitet: 2012-2014,
3. Debat për Raportin e Auditivit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Kaçanikut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Mbledhja e VII-të (Shtatë)

Me 29.07.2011, është mbajtur mbledhja e VII-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Arovimin e Rregullores për transparencë komunale,
2. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit të Auditivit,
3. Vendimi për Arovimin e Raportit të realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor,2011, dhe
4. Kërkesa e AAK-së për debat të çështjes së objektit të banimit më lokale afariste që gjendet në afërsi të QKMF në Kaçanik.

Mbledhja e VIII-të (Tetë)

Me 29.09.2011, është mbajtur mbledhja e VIII-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Rialokim të mjeteve nga ndarjet bugjetore 2011 në kategorinë e projekteve kapitale;
2. Vendimi për Arovimin e Rregullores për vendosjen e Tatimit në Pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2012; dhe
3. Vendimi për Arovimin e Buxhetit të komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2012 dhe vlerësimet për vitet: 2013-2014.

Mbledhja e IX-të (Nëntë)

Me 31.10.2011, është mbajtur mbledhja e IX-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Transparencë Komunale,
2. Vendimi për prolongim të propozim vendimit për caktimin e lokacionit për dhënie në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të komunës për nevoja bujqësore,
3. Vendimi për Prolongim të Propozim-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut,
5. Vendimi për aprovimin e Rregullores për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut, dhe
6. Debat lidhur më Informatën për përfundimin e vitit shkollor 2010/2011.

Mbledhja e X-të (Dhjetë)

Me 30.11.2011, është mbajtur mbledhja e X-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Aprovimin e Raporteve të realizimit të buxhetit të komunës për vitin 2011;
 - 1.1. Raporti nëntëmujor i buxhetit, përfunduar më 30 shtator 2011,
 - 1.2. Raporti i realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën, janar-shtator 2011, dhe
2. Vendimi për rritjen e buxhetit të komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011 nga të hyrat vetjake komunale dhe shpendaria e tyre për shpenzime.

Mbledhja e XI-të (Njëmbëdhjetë)

Me 28.12.2011, është mbajtur mbledhja e XI-të e Rregullt e KK Kaçanik, udhëhequr nga kryesuesi i kuvendit, Xhelal Gashi, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2012,
2. Vendimi për transferin e mjeteve dhe harmonizimet nga ndarjet buxhetore të buxhetit të komunës për vitin 2011,
3. Vendimi për rritjen e buxhetit të komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011 nga granti qeveritar dhe ndarja e tyre për paga dhe mëditje.

MBLEDHJE SOLEMNE

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2011, ka mbajtur 03 mbledhje më karakter Solemn dhe atë; me datë 17.02.2011, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, me 11.06.2011, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10 gusht 2011, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të komunës.

DEBATE PUBLIKE

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2011, ka organizuar dhe mbajtur Debate publike më qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme, dhe për çështje të veçanta, si për buxhetin e komunës për vitin 2011 dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën.

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit nga strukturat vendore është bërë nga MAPL-a, ndërsa nga strukturat ndërkombëtare, mbledhjet e rregullta të Kuvendit, janë monitoruar nga OSBE-a, ndonjë mbledhje është monitoruar edhe nga KFOR-i.

Përgatiti: Shërbimi i Kuvendit,
Makfire Malsiu, zyrtare e kuvendit